DREJTORIA E PËRGJITH... UJËSJELLËS KANAL...
Nr. 1563 Prot.
Datë 7.05.2009

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kryeministri

# URDHËR

Nr. 65, datë 6.5.2009

PËR

## MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", dhe të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve të jetë sipas skemës nr.1, që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve të jetë sipas skemës nr.2, që i bashkëlidhet këtij urdhri.

3. Numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve të jetë, gjithsej, 35 veta.

4. Urdhri nr.254, datë 1.11.2006, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

# VENDIM

Nr. 532 datë 20.8.1996

PËR

## NDRYSHIM STRUKTURE DHE EMËRIM KUADRI

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Minist
datë 14.8.1995 "Për kompetencat për emërimin dhe largimin
të drejtorëve të drejtorive në ministri dhe institucione
qendrore dhe për ndryshimet në strukturat e tyre dhe me pr
e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit
Turizmit, nr.4798, datë 20.8.1996,

1. Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizimeve të emërtohe
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve.

2. Zoti Stavri Ristani, drejtor i Drejtorisë së Uj
Kanalizimeve, emërohet drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme
Ujësjellës-Kanalizimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ALEKSANDËR MEKSI

MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, RREGULLIMIT